

FJALA E DEPUTETIT ENKELEJD ALIBEAU

E HËNË 17 JANAR 2022

Të nderuar qytetarë shqiptarë, kudo që jeni, na dëgjoni dhe shikoni!

Së pari, përfitoj nga ky moment për t'ju uruar juve dhe familjeve tuaja një vit të mbarë, plot shëndet dhe mos u riktheftë ai i kaluari! Të nderuar kolegë, Zonja Kryetare, Përfitoj nga rasti të falenderoj të gjithë kolegët e mi, të cilët më lanë barrën sa edhe privilegjin e vështirë për të qenë në postin e kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike! Gjithashtu, i shpreh falënderimet e mia paraardhësit, kolegut Rushaj, për punën vërtetë cilësore dhe profesionale që ka bërë në muajt e kaluar. Përveç këtij ndryshimi, asgjë nuk ka ndryshuar nga ky parlament që nga zgjedhjet e 25 prillit. Është e qartë për këdo që këtij parlament, më 26 prill e në vazhdim, sot, fatkeqësisht edhe për ca kohë, i ka munguar dhe i mungon legjitimiteti. Ky parlament nuk përfaqëson zërin e shqiptarëve, lëngatën, dhembjen e shqiptarëve, sepse është parlament i vjedhur. Unë besoj se kjo është kryesorja që duhet thënë në këtë vend, edhe pse nuk është vendi i duhur, sepse është detyrimi ynë të sjellim këtu zërin e shqiptarëve. Për sa kohë që këtu vihet për të ngritur zërin e shqiptarëve, besoj se beteja e të gjithë shqiptarëve, jo vetëm e demokratëve, është vetëm me një njeri, kreun e regjimit, Edi Ramën. Kurrë nuk do ta mendoja që kjo do të ishte një betejë për të cilën ndoshta do të kërkonim ndihmë nga zonja Nikolla.

Zonjë, jeni në atë pozicion, por nga Partia Demokratike nuk keni për të qenë kurrë e zgjedhur si ndërmjetëse apo për të kërkuar ndihmë për zgjidhjen e disa problemeve tona. Po, është e vërtetë që ne kemi disa probleme tonat, të cilat i kemi thënë në sytë e publikut, demokratëve dhe shqiptarëve, por ne kemi maturinë, qetësinë dhe pjekurinë politike, edhe për vështirësitë që po kalojmë, t'i zgjidhim në familjen tonë, ashtu siç duhet, duke e parë realitetin në sy, duke e parë problemin në sy dhe duke qenë për shqiptarët, më së pari ndaj demokratëve, njerëzit, të cilët kanë aftësinë politike për të hequr nga qafa e tyre gurin e rëndë që kishte, për të qenë empatik me shqiptarët, për të fituar besimin e tyre, për të folur sinqerisht me shqiptarët, këtu në parlamentin që kjo maxhorancë ua vodhi më 25 prill. Këtu është vendi ku flitet për shqiptarët dhe sigurisht solemniteti e do të tregojmë për shqiptarët se cilat do të jenë sfidat reale të këtij parlamenti në këtë sesion të ri. Sfida është ta kthejmë këtë sallë në vendin ku flitet me zërin e shqiptarëve të varfër, të vjedhur, pa shpresë, pa punë, pa të ardhura, pa siguri. Kjo foltore duhet të përdoret pikërisht për këtë qëllim. Këtë do të bëjmë ne, kjo pjesë, e cila e ka bërë dhe do të vazhdojë ta bëjë me më shumë forcë se më parë, pavarësisht problemeve tona, që i kemi pasur dhe tashmë janë të kaluara. Sfidat tona janë ato, të cilat në këto 4 muaj të parë, pas masakrës së 25 prillit, i filluam dhe me shumë vështirësi arritëm t'i vendosnim në xhiro, por pengesa ishte e qartë.

Po, çështja e zgjedhjeve të 25 prillit nuk ka për t'u mbuluar me sarkofag, sepse nga ajo buron çfarëdolloj defekti dhe disfunksioni i këtij parlamenti. Do ta çojmë deri në fund këtë çështje. Masakra elektorale nuk është thjesht dhe vetëm një faturë që na u vendos neve në mënyrë të padrejtë, ajo u është vendosur shqiptarëve. Është detyrimi ynë, i opozitës, i këtyre burrave dhe grave, të cilët, në një moment të vështirë që vendi po kalon, kanë gjetur të targetojnë atë që është thembra e Akilit e problemit: ky vend nuk bën zgjedhje të lira. Është detyrimi ynë të bëjmë gjithçka, jashtë dhe brenda këtij parlamenti, për t'u kthyer shqiptarëve votën e lirë dhe të ndershme. E dyta, korrupsioni është simptoma më energjike, që vjen pas vjedhjes së zgjedhjeve. Komisioni për insineratorët, aq i debatuar dhe aq i penguar, do të jetë një nga sfidat tona, që do të vazhdojë, pavarësisht pengesave që na vutë:

nuk japin letra, miratojnë rregullore, nuk paraqesin të dhëna. Në fakt, si për njërin, edhe për tjetrin, në këta 4 muaj kanë ndodhur ngjarje të mëdha, ku ndoshta ne nuk e kishim fokusin kryesor, për shkak të problemeve tona, që do t'i zgjidhim gjithmonë në shtëpinë tonë dhe nuk do t'i nxjerrim në mexhlis; kanë dalë të dhëna shumë sensitive, të cilat i kanë bërë akoma më imediate dhe energjike sforcot tona. Një nga ish-ministrat e kësaj qeverie, që më parë ulej këtu, sot është atje dhe është bishti i kavallit, sepse po të ndiqet paraja, follow the money, siç e thonë ata që e kanë nxjerrë këtë sentencë, shumë shpejt, shumë prej këtyre karrigeve do të jenë bosh. Në fakt, kjo është një nga detyrat tona, një nga kërkesat tona, një nga kërkesat e shqiptarëve. Ky është misioni ynë dhe për këtë kemi ardhur ne demokratët këtu dhe për këtë do të vazhdojmë të punojmë gjithnjë e më fort. Po, ne do të vazhdojmë punën për reformën zgjedhore.

Zonjë, ju e thatë në fjalën tuaj, ka kaq kohë që ne e kemi kërkuar reformë zgjedhore reale, të sinqertë, të vërtetë, që targeton pikërisht atë që është problemi kryesor, kardinal, i këtij vendi, që prej shumë vitesh nuk bën më zgjedhje, në të gjithë regjistrat e vet, ligjorë dhe kushtetues. Kjo është kërkesa jonë dhe këtë do ta kërkojmë, sepse e kërkojnë shqiptarët, e kërkojnë partnerët ndërkombëtarë, e kërkojnë raportet e OSBE/ODIHR-it. Po, ne do të vazhdojmë me sfidën tonë për reformën territoriale. Nga viti 2014 e këndeje, ky vend, përveç shumë mangësive të mëdha, nuk ka më pushtet vendor. Ka thjesht dhe vetëm disa ndërtesa të quajtura "bashki", të cilat janë brejtës parash dhe, mbi të gjitha, vende punësimi për militantët, të cilët përdoren në zgjedhje. Për t'u rikthyer asaj, që është çështja kryesore, për të kthyer legjitimitetin në këtë parlament një është kryereforma, më kryesorja, më e rëndësishmja, e dukshme, e prekshme për çdo shqiptar, të majtë, të djathtë, për ata që kanë ikur, për ata që po bëhen gati të ikin apo ata që do të vazhdojnë të jenë këtu: vetingu në politikë. Kjo është sfida morale, politike, juridike, quajeni si të doni, të cilën duhet ta kalojë gjithsecili prej nesh këtu. Për të hyrë në këtë parlament do të duhet tregosh që je imun ndaj korrupsionit dhe kriminit. Kaq pak kërkojnë shqiptarët. Nëse këtu hyn i pastër, por zhytesh në vorbulla të kriminit dhe korrupsionit, duhet të dalësh. Kaq e thjeshtë është ajo që kërkojmë ne me vetingun në politikë.

Kaq ulëritëse është kërkesa e shqiptarëve sot. Nëse do të ndodhë, dhe do të ndodhë, se nuk ka zgjidhje tjetër, atëherë ky vend do t'u kthehet shqiptarëve dhe janë ata që do të vendosin për fatet e tyre. Në këtë mënyrë, kjo është sfida e parë dhe e vetme e të gjithëve ne. Ne e kemi pranuar, duke marrë parasysh çfarëdo kostoje, të gjithsecilit prej nesh. Po ju e pranoni? E pranoni ky? Këtë do të shikojnë shqiptarët në këtë sesion. Për sa u përket çështjeve tona, ato i zgjidhim vetë, sepse e kemi aq mundësi dhe pjekuri, siç kemi marrë të gjithë barrën dhe kostot tona personale. Këtu jemi për hallet e shqiptarëve dhe nuk kërkojmë as bashkëpunim, as ndihmë dhe asgjë nga kjo pjesë apo këndeje. Kjo duhet të jetë e qartë për këdo. Shumë faleminderit!